



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Mars 2022

Nr: 126

VENDIM

PËR

EMËRIMIN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KZAZ NR. 55, QARKU FIER

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, 29, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 9, pika 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 9, pika 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 55, qarku Fier, me vendimin nr. 139, datë 4.3.2022, administruar në KQZ me nr. 1557, datë 4.3.2022, ka propozuar zëvendëskryetar të KZAZ nr. 55, zj. Kozeta Guçi.

Propozimi dhe kandidatura e paraqitur plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 9, pika 7, të vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “ç”, e 2, dhe 29, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



VENDOSI:

1. Të emërojë zëvendëskryetar të KZAZ nr. 55, qarku Fier, zj. Kozeta Guçi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

